



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura V
Sesioni vjeshtor

Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale

Mbledhja nr. 18

Ndërtesa e Kuvendit, salla S - 1

Prishtinë, më 21 shtator 2015, në orën 13:00

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR SHËNDETËSI, PUNË
DHE MIRËQENIE SOCIALE

Në mbledhje morën pjesë: Flora Brovina, Fadil Beka, Hatim Baxhaku, Besa Baftiu, Adem Hoxha, Time Kadrijaj dhe Shukrije Bytyçi.

Munguan: Fikrim Damka dhe Njomza Emini.

Stafi mbështetës i Komisionit: Shpresa Haxhijaj, koordinatore e Komisionit dhe Muhamet Bytyçi, zyrtar i fushës.

Mbledhjen e kryesoi, Flora Brovina, kryetare e Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

REND I DITËS:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës: 29.7.2015;
3. Shqyrtimi i planit të punës së Komisionit për sesionin vjeshtor 2015;
4. Të ndryshme.

Kryetarja e Komisionit, Flora Brovina konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës;

Rendi i ditës u miratua pa asnjë ndryshim.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Komisionit, të mbajtur më 29.7.2015;

Kryetarja Flora Brovina konstatoi se Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, miratoi procesverbalin e mbledhjes së Komisionit, të mbajtur më 29.7.2015, pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i planit të punës së Komisionit për sesionin vjeshtor 2015;

Kryetarja - Të nderuar deputetë. Sot në rend dite kemi shqyrtimin e planit të punës së komisionit për sesionin vjeshtor, andaj ne si komision në sesionin pranveror kemi pranuar vetëm tri projektligje nga Ministria e Shëndetësisë, ku dy prej tyre pothuajse i kemi përfunduar kurse projektligji për shërbimin mjekësor emergjent ka mbet në procedurë, për të cilin e kemi paraparë që t'i shohim praktikat e shteteve të regjionit, siç është Shqipëria dhe Mali i Zi. Pra, projektligjet që kanë mbet, bartën për sesionin vjeshtor, po ashtu në bazë të programit legjislativ të rishqyrtuar kemi edhe dy projektligje të reja nga Ministria Punës dhe Mirëqenies Sociale, pra projektligjin për Ndërmarrjet Sociale në Kosovë si dhe projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për regjistrimin dhe evidencën e të papunësuarve dhe punëkërkesve. Po ashtu gjatë sesionit vjeshtor do të bëjmë një monitorim të zbatimit të një ligji nga Ministria e Shëndetësisë, Ligjin për Shëndetësi apo eventualisht ndonjë ligj tjetër.

Edhe gjatë këtij sesioni do të vazhdojmë që ti ftojme ministrat e ministrive të MSH-së dhe MPMS-së në raportim si dhe do të realizojmë disa vizita në terren, nëpër institucione shëndetësore dhe institucione tjera që janë në fushëveprimin e komisionit.

Time Kadrijaj – Ne kemi pranuar një shkresë nga shoqata e paraplegjikëve, të cilët kanë kërkuar nga ne që si komision funksional të shqyrtojmë Projektligjin për paraplegjikët dhe tetraplegjikët, pasi që shumica prej nesh jemi doktorë dhe bie mbi fushëveprimin e komisionit tonë, andaj propozoj që ti drejtohem me një kërkesë kryesisë dhe të kërkojmë që seanca të na ngarkojë neve si komision funksional për të trajtuar këtë projektligj. Pasi që në bazë të planit të punës së Kuvendit të Kosovës për vitin 2015, Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Personat e Pagjetur dhe Peticione e kanë në plan të punës për të shqyrtuar. Në fakt kërkesa është që të shtyhet ky projektligj, sepse kjo shoqatë mendon se nuk ka gjithëpërfshirje të këtyre kategorive, dhe ajo dëshiron që të gjitha kategoritë të përfshihen në këtë projektligj.

Kryetarja – Pasi që në planin e punës së Kuvendit është përcaktuar një komision tjetër si komision funksional, andaj ne do të shqyrtojmë mundësinë se si të gjejmë një mënyrë të bashkëpunimit, pse jo edhe të kërkojmë që të ngarkohemi si komision funksional për të shqyrtuar këtë projektligj. Ky projektligj akoma nuk ka ardhur në Kuvend dhe në momentin kur të vjen, ne do të diskutojmë se si do të veprojmë.

Besa Baftiu – Sa i përket projektligjit për paraplegjikët dhe tetraplegjikët, edhe unë kam pranuar një shkresë nga shoqatat, të cilat kanë shprehur shqetësimi e tyre pse ne si Komision të mos e shqyrtojmë këtë projektligj, edhe unë jam e pajtimit që ne si komision të shqyrtojmë këtë projektligj.

Shukrije Bytyçi – Të nderuar kolegë, po ashtu edhe unë kam pranuar shkresë nga këto shoqata si dhe nga HANDIKOS-i, që ne si komision funksional të shqyrtojmë këtë projektligj, andaj edhe unë jam e pajtimit si komision ta shqyrtojmë këtë projektligj.

Përfundim

- Komisioni e mbështet propozimin e deputetes Time Kadrijaj, që Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale të ngarkohet si komision funksional, për të shqyrtuar Projektligjin për paraplegjikët dhe tetraplegjikët.

4. Të ndryshme;

Kryetarja - Po ju njoftoj së kërkesa për realizim të vizitës zyrtare në Republikën e Shqipërisë dhe Republikën e Malit të Zi, është proceduar edhe njëherë dhe besoj se shumë shpejt do ti realizojmë këto dy vizita, ku do të shkëmbejmë përvojat tona me komisionet homologe si dhe institucionet tjera të këtyre dy vendeve, që mbulojnë fushëveprimin e komisionit.

Besa Baftiu - Unë do të doja që në mbledhjen e ardhshme të komisionit, të thirret edhe ministri i shëndetësisë në raportim, t'i diskutojmë disa çështje, se a është duke u implementuar sistemi i informimit shëndetësor, të shohim se a është duke vazhduar ky pilot projekt apo jo, po ashtu edhe rreth dhënies së licencës së Spitalit Amerikan.

Kryetarja - Ne e kemi edhe në planin e punës, ku do ti ftojmë ministrat për raportim ku do të mundemi ti diskutojmë këto çështje, po ashtu edhe çështje tjera që ne si komision i konsiderojmë se janë të nevojshme.

Kryetarja - Nëse nuk keni asgjë tjetër, ju falënderoj dhe e shpalli të mbyllur mbledhjen e sotme.

Mbledhja përfundoi në orën 13:55

E përqatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetarja e Komisionit,

Flora BROVINA